



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “BS2” Sh.P.K. të datës 09.08.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 13.07.2023 si dhe dosjes së tenderit të datës 28.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje për pastrimin e Kryeqytetit” me nr. të prokurimit 616-23-7016-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “BS2” Sh.P.K. e datës 09.08.2023 kundër njoftimit për kontratë të datës 13.07.2023 si dhe dosjes së tenderit të datës 28.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje për pastrimin e Kryeqytetit” me nr. të prokurimit 616-23-7016-1-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “BS2” Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “BS2” Sh.P.K. (tutje “parashtruesi”) me datë 09.08.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë të datës 13.07.2023 si dhe dosjes së tenderit të datës 28.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje për pastrimin e Kryeqytetit” me nr. të prokurimit 616-23-7016-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetçur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet themelore të parashtruesit janë si në vijim: “Kërkesa për të ofruar automjete me shasi të prodhuara ekskluzivisht nga i njëjti prodhues ka krijuar pa dashje një situatë që potencialisht mund të diskriminojë disa operatorë ekonomikë dhe të kufizojë konkurrencën në procesin e tenderimit, pasi që vetë autoriteti kontraktues ka kërkuar 2 lloje të ndryshme të shasive. Shqetësimi ynë buron nga fakti se kjo kërkesë duket se favorizon një prodhues shasi të aftë për të prodhuar të dy llojet e shasisë. Kjo mund të çojë pa dashje në një avantazh monopolist për atë prodhues, duke krijuar një fushë loje të pabarabartë për të gjithë operatorët ekonomikë që marrin pjesë në tender. Në frymën e konkurrencës së ndershme dhe sigurimit të një grupi sa më të gjerë të ofertave, ne kërkojmë që sugjerimet tona të merren parasysh për përmirësimin e procesit të tenderit. Ne propozojmë që kërkesa të rishikohet për të lejuar ofrimin e automjeteve me brende të ndryshme të shasisë. Ky rregullim do të nxiste një mjedis ofertash më gjithëpërfshirës, duke inkurajuar një spektër më të gjerë operatorësh ekonomikë për të marrë pjesë. Duke lejuar lloje të ndryshme të shasive nga prodhues të ndryshëm, procesi i tenderit potencialisht mund të japë zgjidhje më të larmishme dhe inovative, të cilat nga ana e tyre përputhen me objektivat përfundimtare të autoritetit kontraktor. Ne besojmë fuqimisht se rishikimi i kërkesave siç sugjerohet jo vetëm që do të eliminonte diskriminimin e mundshëm, por gjithashtu do të nxiste një atmosferë konkurruese nga e cila përfitojnë të gjitha palët e përfshira. Synimi ynë është që të kontribuojmë në suksesin e përpjekjeve të Kuvendit të Komunës së Prishtinës duke siguruar drejtësi dhe mundësi të barabarta për operatorët ekonomikë”.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 16.08.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Lidhur me pretendimet e parashtruesit zyrtari përgjegjës i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuese që të rivlerësojë nëse kërkesat në dosjen e tenderit janë në përputhje me LPP. Rrjedhimisht me njësia kërkuese është përgjigjur ashtu që nuk ka gjetur mospërputhje mes kërkesave të dosjes së tenderit dhe LPP me arsyetimin si në vijim: “Asnjë nga prodhuesit e shasive nuk e bën prodhimin e mbindërtimeve që nënkupton se prodhuesit e shasive janë të ndryshëm dhe prodhuesit e mbindërtimeve janë të ndryshëm. Të gjithë prodhuesit serioz të shasive prodhojnë pothuajse të gjitha llojet e shasive dhe kjo është një arsye mjaft e madhe pse duhet të jetë një prodhues i vetëm dhe jo të ketë laramani prodhuesish. Ne e shohim të arsyeshme kërkesën tonë që të gjitha shasitë të jenë nga një prodhues i vetëm dhe mbindërtimet poashtu të jenë nga një prodhues i vetëm. Kjo e lehtëson mjaft shumë mirëmbajtjen e këtyre makinave në periudhë afatgjatë e poashtu lehtëson mjaft shumë procedurat e operatorit karshi prodhuesve dhe garancive. Mendojmë se në momentin që nuk kemi kufizuar prodhuesit e shasive dhe mbindërtimeve, kërkesa jonë nuk është diskriminuese. Ne besojmë në praktikën dhe logjikën e përdorur pothuajse nga të gjitha ndërmarrjet shtetërore dhe private të cilat posedojnë flota makinerish të cilat gjithmonë zgjedhin një prodhues të caktuar për të përmushur nevojat e tyre sepse në të gjitha aspektet kjo formë është shumë më efikase dhe ekonomikisht shumë më e levërditshme”.

Për Autoritetin Kontraktues është e domosdoshme që ky aktivitet i prokurimit të realizohet me sukses ashtu që projekti të implemetohet në mënyrë profesionale, me cilësi të lartë dhe në përputhje me standardet e fundit ndërkombëtare.

Përmes nenit 10 par. 10.1 nënparagrafi b) të RRPP është përcaktuar se njësia e kërkesës e cila ka inicuar aktivitetin e prokurimit ndër të tjera ka përgjegjësinë që të "Përgatit/proponon detyrën projektuese, projektin, specifitime teknike (ST), Termat e Referencës (TeR), dhe Paramasen dhe Paralogarinë". Në rastin konkret njësia kërkuese ka përgjegjësinë për kërkesat e dosjes së tenderit të publikuar lidhur me aktivitetin përkatës të prokurimit.

Sa i përket pretendimeve ankimore me rastin e sigurimit të përgjigjes së cituar më sipër nga njësia kërkuese, zyrtari përgjegjës i prokurimit ka përmeshur përgjegjësitë e tij në kuptim të nenit 11 par. 11.3 nënpar. b) të RRPP ku përcaktohet se zyrtari i prokurimit "në bashkëpunim me Udhëheqësit e Njësive kërkuese, koordinon të gjitha dokumentet, projektet, specifikimet, TeR, Paramasat dhe Paralogaritë dhe vizatimet".

Nga sa u tha më sipër, lidhur me pretendimet ankimore zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë përgjigjes së njësisë kërkuese të cituar më lartë dhe ka gjetur se kërkesat e dosjes së tenderit janë në përputhje me nenin 27 të LPP.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 16.08.2023

Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.